



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:028919

Datë: 15.07.2022

Numri i dokumentit: 03234133

P.nr.102/2022

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, në përbërje me Gjyqtarin e vetëm Gjykues Qemal Suka si dhe me pjesëmarrjen e sek.juridike Vjollca Bytyçi, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit A. H. B. nga fshati P. Komuna Suharekë, për shkak të veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së nr.06/L-074, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prizren, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.83-14/22 të datës 03.03.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të prokurorit të shtetit Faos Ajvazi dhe të akuzuarit A. B. me datë 05.07.2022 mori, publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.07.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, A. B. nga i ati H. e nëna B., e lindur D., i lindur me datë në fsh. P. Komuna Suharekë, ku dhe tani jeton, i martuar baba i një fëmiu, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion kamarier, i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës. me nr.personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 13.12.2021 rreth orës 01:25 minuta në rrugën lokale Suharekë – V. saktësisht në hyrje të fshatit S., te rruga e lagjes “B.” drejton automjetin në gjendje të paaftë përkatësisht nën ndikim të alkoolit, në atë mënyrë që derisa po drejtonte veturën Pikap “Opel Corsa Combo” ngjyrë e kaltër, me targa 04-...-IL, nuk e respekton ligjin e komunikacionit rrugor, përkatësisht vepron në kundërshtim me nenin 53 dhe 233 të Ligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që duke mos e përshtatur shpejtësinë kushteve të rrugës dhe nën ndikim të alkoolit me 0.64% promilë alkool në gjak, shkakton aksident komunikacioni duke përfunduar jashtë rrugës në anën e majtë të drejtimit të lëvizjes ku përplaslet me një beton të ujëmbledhësit të ujit atmosferik dhe rrokulliset me veturën që po drejtonte, me ç’rast vetë vozitësi pëson lëndime të lehta trupore, përkatësisht ndrydhje të indeve të buta, gërvishtje dhe plagë shqyese në kokë, tronditje të dorës së majtë dhe gjurit të majtë, si dhe thyerje të radiusit të dorës së majtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të furishëm si pasojë e aksidentit të trafikut, të përshkruara si në akt ekspertizën mjeko-ligjore të datës 24/01/2022.

Me këto veprime ka kryer veprën penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 3 lidhur me par.1 të Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 21, 38, 39 par. 1 pika 1. 2 dhe 1.3, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KP-së, si nenit dhe 365 të KPP-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Duke ia caktuar dënimin me burgim prej 2 viteve, i cili nuk do të ekzekutohet nëse në kohën e verifikimit prej tri viteve nuk kryen vepër tjetër penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe,

Konform dispozitave të nenit 59 par. 1 dhe 2 nën par. 2.5 si dhe nenin 64 par. 1 dhe 2 të KP-së i shqipton,

Dënim plotësues

Ndalimi i drejtimit të automjetit të kategorisë B, në kohëzgjatje prej dy vite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të ekspertizës së komunikacionit të paguaj shumën prej 150 euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 20 euro, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën 30 euro në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumën prej 20 euro, të gjitha pas plotfuqishmërisë së aktgjykimi.

Pala e dëmtuar N. K. nga fsh. V. komuna Suharekë, udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prizren me anë të aktakuzës PP.II.nr.83-14/2022 të datës 03.03.2022 ka akuzuar A. B. nga fshati P. Komuna Suharekë për veprën penale ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 3 i Kodit nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës.

Gjykata ka mbajtura shqyrtim fillestar me datë 05.07.2022 në prezencë të prokurorit të shtetit Fatos Ajvazi dhe të akuzuarit, prokurori i shtetit në tersi ka qëndruar pranë të dhënave si në aktakuzë duke kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet në bazë të ligjit.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit, i akuzuari ka theksuar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë. Prokurori i Shtetit nuk ka pasur kundërshtime lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit e ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike Gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë të të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë si në kallëzimin penal 2021 -GR-... të datës 13.01.2022, deklaratës së të dëmtuarit të dhënë prokurori me datë 16.02.2022, procesverbalit mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit A. B. dhënë në prokurori me datë 16.02.2022, raportin mjekësor të lëshuar nga shërbimi urgjent në Suharekë dt 13.12.2021, raportin mjekësor të dt.13.12.2021 lëshuar nga Spitali Rajonal Prizren, Akt-ekspertimin mjeko-ligjor të dt . 24.01.2022 nga dr.F. B., ekspertizen e komunikacionit te dt 19.02.2022 hartuar nga B. A. si dhe provave tjera materiale të bashkangjitura aktakuzës.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 të KPP-së në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar

natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit, është bërë vullnetarisht në shqyrtimin fillestar pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe provat materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH-së në Prizren.

Gjykata po ashtu në tërësi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 të KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale ngasja në gjendje të paafte apo të dehur nga neni 371 par. 3 lidhur me par.1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, andaj gjykata ka vendosur se i akuzuari është fajtor dhe i shqiptoj dënim me kusht duke ia caktuar dënimin me burgim prej 2 (dy) vitesh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në kohën e verifikimit prej tre vite i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe dënimin plotësues, ndalimi i drejtimit të automjetit të kategorisë B, në kohëzgjatje prej dy vite.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KP-së, të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit, si rrethanë rënduese gjykata e vlerësoi mënyrën e kryerjes së veprës penale pasi që si pasojë e kryerjes së veprës penale i dëmtuari Naim Kolgeci ka pësuar lëndime të rënda trupore, ndërsa si rrethanë lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari duke shprehur keqardhje dhe zotim se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, andaj gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si dhe dënimin plotësues, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij penale dhe se më këto dënime do të arrihet qëllimi i duhur ndëshkimi që i akuzuari në të ardhmen mos të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 463 par. 2 të KPP-së, pasi gjykata në këtë procedurë nuk kishte nxjerrë prova mbi lartësinë e demit ndërsa të dhënat në shkresat e lëndës nuk jepnin bazë të sigurt për gjykimin e plotë apo të pjesëshëm të saj.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mor në kuptim të nenit 450 të KPP-së.

Vendimi me të cilin është i obliguar i akuzuari që të bëjë kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit. Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.